

LIGJ
Nr.7722, datë 15.6.1993

PËR MBROJTJEN E FONDIT TË BIMËVE MJEKËSORE, ETEROVAJORE E TANIFERE NATYRORE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Fondi i bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore që rriten e zhvillohen në territorin e Republikës së Shqipërisë është pasuri kombëtare.

Pronësia dhe administrimi i tyre njësohet me sipërfaqen e tokës ku ato rriten e zhvillohen.

Neni 2

Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe organet e saj vartëse ngarkohen të marrin masa për mbrojtjen, shtimin e mirërritjen e bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore. Në sipërfaqet që janë pronë e shtetit ajo cakton zonat, afatet, llojet, kontigjentet dhe jep lejën e vjeljes e të grumbullimit të tyre.

Neni 3

Personat fizikë a juridikë që do të vjelin bimë mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore, janë të detyruar të pajisen me lejë nga drejtoria e shërbimit pyjor e juridiksionit ku ato rriten.

Neni 4

Bimët mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore që janë në pakësim dhe rrezikohen të zhduken përcaktohen me listë të veçantë nga ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit, në muajin tetor të çdo viti. Ai shpall ndalimin që këto bimë të vilen, grumbullohen dhe eksportohen për një afat të caktuar, deri në shtimin dhe ripërtëritjen e tyre. Ky ndalim përfshin bimësinë e të gjitha formave të pronësisë.

Neni 5

Vjelja e bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore bëhet sipas kriterëve teknike që përcaktohen me rregullore të veçantë nga ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit, pavarësisht nga pronësia e tyre.

Ndalohet që në fondin e këtyre bimëve të kryhet çdo lloj veprimtarie që çon në shkatërrimin, dëmtimin, uljen e prodhimit të tyre, me përjashtim të rasteve të përcaktuara nga ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit.

Neni 6

Të drejtën e kontrollit për zbatimin e këtij ligji, e kanë organet e shërbimit pyjor.

Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative bëhet nga një komision prej jo më pak se tre vetash pranë drejtorisë së shërbimit pyjor, përbërja e të cilit caktohet nga drejtori i saj.

Neni 7

Shkelja e dispozitave të këtij ligji, të parashikuara në nenet 3, 4 e 5 kur vlefta e materialit bimor të mbledhur është mbi 1000 lekë konsiderohet kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 250 deri 10000 lekë dhe me marrjen e materialit bimor ose të kundërvleftës së tij kur ai mungon.

Neni 8

Ankimi kundër vendimit të dënimit të kundërvajtjes administrative dhe ekzekutimi i vendimeve bëhet sipas procedurës të parashikuar në ligjin nr.7697, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative".

Neni 9

Ngarkohet ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit të nxjerrë aktet përkatëse nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas shpalljes.

Shpallur me dekreten nr.586, datë 29.6.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.